

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E RAHOVECIT OPSTINA ORAHOVAC MUNICIPALITY OF RAHOVEC	
---	--	---

Për:	Operatori Ekonomik: PRO MEDICAL SH.P.K., Rr. Kadri Zeka, 70000, Ferizaj Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	24.09.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 63 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik, sa i përket **Kërkesës për Rishqyrtim** të datës: **23.09.2024**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik: **PRO MEDICAL SH.P.K.** me adresë në **Ferizaj**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **SERVISIMI I PAJISJEVE MJEKËSORE – RITENDERIM**, me Numër të prokurimit: **623-24-8427-2-2-1**, Numër i brendshëm: **623-24-017-2-2-1**, nxjerr:

VENDIM

- I. **REFUZOHET** si e pa bazuar kërkesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik: **PRO MEDICAL SH.P.K.** me adresë në **Ferizaj**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **SERVISIMI I PAJISJEVE MJEKËSORE – RITENDERIM**, me Numër të prokurimit: **623-24-8427-2-2-1**, Numër i brendshëm: **623-24-017-2-2-1**, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK-së, të datës: **18.09.2024**, të publikuar në ueb – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- II. Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdoj me Njoftim Mbi Vendimin e Autoritet Kontraktues për aktivitetin e prokurimit, me Numër të prokurimit: **623-24-8427-2-2-1**, Numër i brendshëm: **623-24-017-2-2-1**
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

A R S Y E T I M

Operatori Ekonomik: **PRO MEDICAL SH.P.K.** me adresë në **Ferizaj**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **SERVISIMI I PAJISJEVE MJEKËSORE – RITENDERIM**, me Numër të prokurimit: **623-24-8427-2-2-1**, Numër i brendshëm: **623-24-017-2-2-1**, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK-së, të datës: **18.09.2024**, të publikuar në ueb – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: **23.09.2024**, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

BAZA LIGJORE PËR REFUZIM TË KËRKESËS

Përgjigje për pretendimet e tua ankimore:

Ju sqarojmë se pretendimet e tua ankimor nuk qëndrojnë dhe janë të pabazuar, pasi që vlerësimi i ofertave është bërë konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik Autoriteti Kontraktues: Komuna e Rahovecit, ju ka Njoftuar juve si Operator Ekonomik ankues, sipas formularit **B42 Letër Standarde për tenderuesin e eliminuar**, ku kemi cekur:

Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye:

Ju njoftoj se ju si O.E. nuk i keni plotësuar kërkesat minimale sipas Dosjes së tenderit tek Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT):

Me datë: 27.08.2024, me Letër Standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit, kemi kërkuar këto sqarime:

Dërguar në: PRO MEDICAL SH.P.K. ✓ ✓
B47 Letër Standarde e kërkeses per sqarimin e tenderit
B47 Letër Standarde e kërkeses per sqarimin e tenderit -.pdf 27.08.2024 14:16
Hape:
Ngarko:

Për të vlerësuar tenderin e juaj në mënyrë të duhur, ne kërkojmë që të siguroni sqarimin e tenderit të juaj si në vijim:

Në bazë të Ligjit të Prokurimit Publik, në përputhje me nenin 72 kërkoj sqarime shtesë ku

thotë: Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji;

Ne ofertën e juaj të dorëzuar, mungon Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare;

Bazuar në tabelarin e UDHËZUES Nr. 001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK, në faqen 40 kemi shembullin se si duhet vepruar:

Mungon dëshmia mbi gjendjen ekonomike dhe financiare	Mund të kërkojen informata sqaruese	68
--	-------------------------------------	----

Ne si Autoritet Kontraktues: Komuna e Rahovecit, kërkojmë nga ana juaj të na dorëzoni informacionet qe mungojnë, në bazë të sqarimeve te lartcekura, duke u bazuar në nenin 72

Ne ofertën e juaj të dorëzuar, për Kërkesën Nr. 4:

Dy (2) Serviser me certifikata trajnimi për pajisje biokimike dhe hematologjike, keni prezantuar:

Blendi Behluli dhe Nazim Lohaj;

Por në Ofertën e dorëzuar, NUK keni prezantuar, dokumentet e kërkuara sipas **Dëshmisë Nr. 4** të kërkuar dokumentare:

• **CV-në (të nënshkruar nga vetë pala);**

Ne si Autoritet Kontraktues: Komuna e Rahovecit, kërkojmë nga ana juaj të na dorëzoni informacionet qe mungojnë, në bazë të sqarimeve te lartcekura, duke u bazuar në nenin 72

• **Kopje e noterizuar e kontratës së punës me punëdhënësin në prani të palëve ose marrëveshja e noterizuar mbi angazhim për këto shërbime në prani të palëve;**

Si dëshmi për personat duhet te ofrohet kontrata dhe lista e pagave nga ATK, ngase ekzistenca ofrimit të para kontratës para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, në këtë rast nuk mund të verifikohet në mënyrë objektive.

VËREJTJE: Neni 72, paragrafi 3. thotë: Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.

Përgjigjja ose përgjigjet e juaja sqaruese duhet të pranohen prej nesh **me shkrim** në adresën e lartë shënuar të autoritetit kontraktues apo në e-mailit: [prokurimi.rahovec@gmail.com] brenda **[4 ditëve]** nga data e kësaj kërkesë, përkatësisht deri me datë: **30.08.2024**, në ora: **14:00 h.**

Ju si Operator Ekonomik, me datë: 29.08.2024, nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik

Dërguar nga : PRO MEDICAL SH.P.K.	29.08.2024 14:31
Dokumenti për dërgim te AK	
Informacione shtës për Letër Standarde e kërkesës për informata mbi tenderët dhe dokumente shtese.pdf	29.08.2024 14:31
Hape:	<input type="button" value="Shqip"/>

Dhe ne formë fizike, nëpërmjet Protokollit Numër: 01-151/02-0035913/24,

Keni dorëzuar dokumentacionet vetëm për Kapacitetin Teknik dhe Professional,

Por ju si Operator Ekonomik NUK jeni përgjigjur ne kërkesën tonë sipas Letrës Standarde e kërkesës për sqarimin për Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare, andaj oferta juaj konsiderohet e papërgjegjshme konform nenit 59.4 të LPP-së

Kapaciteti teknik dhe profesional:

Kërkesa 1: Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme, në tri vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, në vlerë min. 45,000.00 Euro;

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Dëshmia 1: Lista e shërbimeve të kryera në lëmin e shërbimeve të ngjashme të realizuar në tri vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, duke saktësuar: Shërbimet e kryera, shumën e kontratës, vendit dhe Nr. e Prokurimit – duhet të dorëzohet në origjinal, i nënshkruar dhe i vulosur nga Operatori Ekonomik, e përcjellur me Kopje të Referencës përkatëse ose raportet e pranimit si dëshmi se kontrata është përmbushur me sukses;

Sqarimet janë si në vijim:

Në Njoftim për Kontratë dhe Dosjes së tenderit të Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT), tek Kapaciteti teknik dhe profesional, është kërkuar që Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme, në tri vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, DHE dëshmitë e përfundimit, Kopje të Referencës përkatëse ose raportet e pranimit si dëshmi se kontrata është përmbushur me sukses;

Referenca/t ose raportet e pranimit si dëshmi se kontrata është përmbushur me sukses në lëmin e Shërbimeve të ngjashme, janë në vlerë: 14,999.10 Euro, ndërsa janë kërkuar në vlerë min. 45,000.00 Euro.

Referenca/t ose raportet e pranimit të tjera të prezantuara nga ana juaj janë kryesisht me Aktivitetet të furnizim, andaj oferta juaj konsiderohet e papërgjegjshme konform nenit 59.4 të LPP-së

Për këtë çështje referohuni opinionit të KRPP Nr. 11 i datës 09.06.2023, dhe Vendimit të OSHP-së Nr. 2023/1056;

Kapaciteti teknik dhe profesional:

Kërkesa 3: Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me Certifikatën ISO 9001-2015 (Certifikata për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë), Fushë veprimtaria: Servisim të pajisjeve mjekësore;

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Dëshmia 3: Dëshmia 3: Certifikatat Valide dhe Kopje e noterizuar nga origjinali;

Sqarimet janë si në vijim:

Në Njoftim për Kontratë dhe Dosjes së tenderit të Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT), tek Kapaciteti teknik dhe profesional, është kërkuar që Operatori ekonomik duhet të ofrojë Certifikatat Valide dhe Kopje e noterizuar nga origjinali;

Në Ofertën e prezantuar është dorëzuar Vërtetimi i Certifikatës nga Kopje nga Kopja e Zakonshme.

Noteri në shkresën e tij, konfirmon duke cekur: *me kërkesë që t'i vërtetoj kopjen e dokumentit nga kopja e zakonshme.*

Për këtë çështje kemi edhe Rekomandim nga Zyra Kombëtare e Auditimit, andaj oferta juaj konsiderohet e papërgjegjshme konform nenit 59.4 të LPP-së

Pretendimi ankimor i parashtruar nga OE me Nr. 1 citoj:

Arsytimi 1 i AK per eliminim tone si me poshte nuk qendron.

Ne ofertën e juaj të dorëzuar, për Kërkesën Nr. 4:

Dy (2) Service me certifikata trajnimi për pajisje bioteknike dhe hematologjike, keni prezantuar: **Blendi Behluli dhe Nazim Lohaj**;

Por në Ofertën e dorëzuar, NUK keni prezantuar, dokumentet e kërkuara sipas **Dëshmitë Nr. 4** të kërkuar dokumentare:

• CV-në (të nënshkruar nga vetë pala);

~~Ne si Autoritet Kontraktues Komuna e Rahovecit kërkojmë nga tregëtarët që dorëzojnë informacionet që mungojnë bazuarë sipat mëve të listës së punës me punëdhënësin në prani të palëve ose marrëveshja e noterizuar~~

• Kopje e noterizuar e kontratës së punës me punëdhënësin në prani të palëve ose marrëveshja e noterizuar mbi angazhim për këto shërbime në prani të palëve;

Si dëshmi për personat duhet të ofrohet kontrata dhe lista e pagave nga ATK, ngase ekzistenca afërim të para kontratës para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, në këtë rast nuk mund të verifikohet në mënyrë objektive.

Arsytimi i OE për Pretendimin 1 ndaj AK-së: Ne kemi dorëzuar dokumentet e kërkuara sipas kërkesës së AK-së më datë 29.08.2024, duke përmbyshur të gjitha kërkesat në formë elektronike dhe në formë fizik pra edhe orgjinalin kemi dozuar, pra ritheksim ne kemi dorëzuar edhe dokumentet e kërkuara edhe në formë fizike, të cilat janë

3/3

origjinale. Dokumentet e listuara më poshtë janë dorëzuar si në mënyrë fizike ashtu edhe në formë elektronike. Lista e dokumenteve të dorëzuara është si më poshtë:

- CV-në (të nënshkruar nga vetë pala); CV e punëtorit **Blendi Behluli dhe Nazim Lohaj** këto dokumente janë bashkangjiture kësaj shkrese, gjithashtu edhe nje **ORIGJINAL** është dorëzuar në Zyren e Prokurimit.

- Kopje e noterizuar e kontratës së punës me punëdhënësin në prani të palëve ose marrëveshja e noterizuar mbi angazhim për këto shërbime në prani të palëve; Pra kësaj shkrese janë bashkangjiture edhe kopje e e kontratave të pra Vërtetim i kopjese (me vule të noterit) për **Blendi Behluli dhe Nazim Lohaj** dhe nje **Orgjinal** i skenduar, gjithashtu edhe nje **ORIGJINAL** është dorëzuar në Zyren e Prokurimit.

• **Lista e Punëtorëve nga ATK per vitet nga 2021-2024-Verifikuar dhe Vulosur nga ATK**

Blendi Behluli dhe Nazim Lohaj ,Listën e pagave të ATK, ku kjo dëshmon se personat /punëtorët kanë kontrata valide dhe janë në listën e pagave në ATK,

Pra, bazuar në dëshmitë e dorëzuara si në formë elektronike ashtu edhe fizike (origjinale), ne kemi plotësuar kriterin e përmendur më sipër, dhe pretendimet e AK-së për eliminimin tonë janë të pabazuara.

*Ridergojm përseri nje kopje elektronike kurse orgjinalet i keni në ne zyren tuaj

Përgjigjia e AK ndaj Pretendimit Ankimor me Nr. 1

Sipas nenit 59 paragrafi 4 i LPP-ës, Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Në B42 Letër Standarde per tenderuesin e eliminuar, kemi cekur arsyetim për eliminimin tuaj:

Ne ofertën e juaj të dorëzuar, mungon Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare;

Bazuar në tabelarin e UDHËZUES Nr. 001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK, në faqen 40

kemi shembullin se si duhet vepruar:

Mungon dëshmia mbi gjendjen ekonomike dhe financiare	Mund të kërkohen informata sqaruese	68
--	-------------------------------------	----

Ju si Operator Ekonomik, me datë: **29.08.2024**, nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik dhe ne formë fizike, **nëpërmjet Protokollit Numër: 01-151/02-0035913/24**, keni dorëzuar dokumentacionet **vetëm për Kapacitetin Teknik dhe Professional**, por ju si Operator Ekonomik **NUK jeni përgjigjur** ne kërkesën tonë sipas Letrës Standarde e kërkesës për sqarimin **për Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare**

Pretendimi juaj në këtë pikë është i **pabazuara**

Pretendimi ankimor i parashtruar nga OE me Nr. 2 citoj:

Arsytimi 2 i AK per eliminim tone si me poshte nuk qendron.

Kapaciteti teknik dhe profesional:

Kërkesa 1: Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme, në tri vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, në vlerë min. 45,000.00 Euro;

Arsytimi i OE për Pretendimin 2 të AK.

Ne kemi dorëzuar listën e projekteve me vlerë totale prej 1,686,408.48 euro, ku vetëm shërbimet apo servisimi kapin vlerën prej 427,301.24 euro.

Ne kemi dorëzuar vetëm një pjesë të referencave dhe raporteve të pranimit, sepse kemi paraqitur referenca të mjaftueshme besoj që plotësojnë këtë kriter, por kemi akoma raporte te pranimit të shërbimeve qe nese kërkohet nga AK do to dorzohen konfrom Neni 72. Gjithashtu, AK ka pasur mundësinë, sipas Nenit 72 dhe Udhëzuesit Nr.001/2023 për Prokurimin Publik, të kërkojë informacion shtesë, sipas udhëzimeve në vijim, dhe jo të refuzojë ofertën tonë pa respektuar Udhëzuesin Nr.001/2023 për Prokurimin Publik.

AK mund të kishte marrë informacionin dhe sqarimet e nevojshme në përputhje me Nenin 72 të LPP-së dhe Udhëzuesin Nr.001/2023, pika 10.1.

Përgjigjia e AK ndaj Pretendimit Ankimor me Nr. 2

Sipas nenit 59 paragrafi 4 i LPP-ës, Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Në B42 Letër Standarde per tenderuesin e eliminuar, kemi cekur arsyetim për eliminimin tuaj: Referenca/t ose raportet e pranimit si dëshmi se kontrata është përmbushur me sukses në lëmin e Shërbimeve të ngjashme, janë në vlerë: 14,999.10 Euro, ndërsa janë kërkuar në vlerë min. 45,000.00 Euro.

Referenca/t ose raportet e pranimit të tjera të prezantuar nga ana juaj janë kryesisht me Aktivitetet të furnizim, andaj oferta juaj konsiderohet e papërgjegjshme konform nenit 59.4 të LPP-së

Pretendimi juaj në këtë pikë është i **pabazuara**

Ndërsa sipas Udhëzuesit Nr. 001/2023 për Prokurim Publik, thotë: me vet faktin që paragrafi i latë cituar përmend fjalën **mund** dhe jo kushtrimisht **duhet**, dhe ne si AK kemi pranuar vetëm referencat që janë prezantuar ne Ofertën e dorëzuar në **lëmin e Shërbimeve të ngjashme**

Pretendimi juaj në këtë pikë është i **pabazuara**

Pretendimi ankimor i parashtruar nga OE me Nr. 3 citoj:

Arsytimi 3 i AK për eliminim tone si me poshte nuk qendron.

Dëshmia 3: Dëshmia 3: Certifikatat Valide dhe Kopje e noterizuar nga origjinali;

Sqarimet janë si në vijim:

Në Njoftim për Kontratë dhe Dosjes së tenderit te Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT), tek Kapaciteti teknik dhe profesional, është kërkuar që Operatori ekonomik duhet të ofrojë Certifikatat Valide dhe Kopje e noterizuar nga origjinali;

Në Ofertën e prezantuar është dorëzuar Vërtetimi i Certifikatës nga Kopje nga Kopja e Zakonshme.

Noteri në shkresën e tij, konfirmon duke cekur: *me kërkesë që t'i vërtetoj kopjen e dokumentit nga kopja e zakonshme.*

Arsytimi i OE për Pretendimin 3 të AK.

Verifikimi dhe noterizimi i certifikatës ISO 9001 është kryer nga Noteri në përputhje me Ligjin Nr. 06/L-010 për Noterinë. Për më shumë detaje, ju lutem referojuni emailit të konfirmimit dhe interpretimit ligjor të Noterit lidhur me pretendimin tuaj për eliminimin tonë në lidhje me certifikatën ISO 9001. Ju si Autoritet Kontraktues (AK) keni pasur mundësinë të kërkonte informacion shtesë në lidhje me këtë çështje, në përputhje me LPP Neni 72-**Dokumentacioni dhe informacioni shtesë**-Prandaj, autoriteti kontraktues, në përputhje me Nenin 59.2 dhe Nenin 72, ka pasur mundësinë të kërkojë sqarime nga ne e jo të eliminon nga ky aktivitet prokurimi, në kundërshtim me LPP Neni 59.2 dhe Neni 72 dhe A02_Udhezues Nr-001_2023 per prokurimin publik piken 10.1 pra, ku në bazë Neni 72 paragrafi 2 "**Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji** (ky citat është nga Ligji Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS I ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092(Versioni i Konsoliduar).

Ju lutem, shikoni emailin më poshtë ose emailin si dëshmi nga Noteri, lidhur me arsyetimin tuaj për eliminimin tonë, i cili është i pabazuar, sepse, citoj: "***kopje e dokumentit te certifikuar apo kopje e zakonshme e dokumentit original dhe ne kete rast noteri deklarone qe kopja perputhet me qdo aspekt me kopjen me pare se me dokumentin original qe nuk eshte prezentu, munde te verteton si kopje e zakonshme***"

Ose ju lutem shikoni emial si provë e bashkangjiture kësaj ankese

Pro Medical

Përgjigjia e AK ndaj Pretendimit Ankimor me Nr. 3

Sipas nenit 59 paragrafi 4 i LPP-ës, Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Në B42 Letër Standarde per tenderuesin e eliminuar, kemi cekur arsyetim për eliminimin tuaj:

Në Njoftim për Kontratë dhe Dosjes së tenderit te Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT), tek Kapaciteti teknik dhe profesional, është kërkuar që Operatori ekonomik duhet të ofrojë Certifikatat Valide dhe Kopje e noterizuar nga origjinali;

Në Ofertën e prezantuar është dorëzuar Vërtetimi i Certifikatës nga Kopje nga Kopja e Zakonshme.

Noteri në shkresën e tij, konfirmon duke cekur: *me kërkesë që t'i vërtetoj kopjen e dokumentit nga kopja e zakonshme.*

Për këtë çështje kemi edhe Rekomandim nga Zyra Kombëtare e Auditimit, andaj oferta juaj konsiderohet e papërgjegjshme konform nenit 59.4 të LPP-së

Por edhe ne email te prezantuar nga Noteri thotë: është kopje e dokumentit te certifikuar apo **kopje e zakonshme e dokumentit**

Pretendimi juaj në këtë pikë është i **pabazuara**

Pretendimi ankimor i parashtruar nga OE me Nr. 4 citoj:

Pjesa II

AK në kundërshtime me LPP Neni 59, i cili trajton Ekzaminimin, Vlerësimin dhe Krahasimin e Tenderëve, ka rekomanduar një Oferues Ekonomik (OE) që nuk ka plotësuar Fletën e Dhënies së Tenderëve (FDT). Në besojmë se ky OE i rekomanduar nuk ka vepruar me përgjegjshmëri. Gjithashtu, është evidente se Autoriteti Kontraktues (AK) ka aplikuar standarde të dyfishta ndaj nesh, duke na diskriminuar si kompani dhe duke favorizuar OE-në e rekomandua.

Pjesa II - Pretendimi 1 i OE Pro Medical ndaj OE të rekomanduar për kontratë nga AK.

Parmasa e OE të rekomanduar nuk është plotësuar saktë. Shiko provën më poshtë dhe kalkulimin në Excel që kemi dërguar të korigjuar. Nëse bëhet fjalë për një kalkulim me disa numra, numri përfundimtar nga fillimi deri në fund vendoset në totalin e kalkular. Pas kësaj, totali duhet t'i shtohet kalkulimit tjetër sipas grupit 35% dhe jo 65% siç ka vepruar OE i rekomanduar

Sticky Note 1:
 Pjesa me nr rendor ne Excel nga 9-81 se bashku eshte vlara Total=7,280.00 euro ose ne grupin 65% pra tek Total nr Excel 82.
 Kurse shuma e kalbrime, aplikimet etj 1,2,3 (ose Excel 83,84,85 baje 720.00 euro kjo shkon ne kategorin 35% sepse nuk mund qe pas Totalit te shtohen kalkulim tjera siq ka bere OE i rekomanduar na kete rast ose 7,280.00+720.00 8,000.00 euo dhe ky gabim është mbi 2%.

Sticky Note 2:
 Shume prej 720.00 euro kalkulohet ne grupin 35% dhe i shtohet Totalit 3710+720=4,430.00 euro edhe kjo eshte mbi+2%

Nr.	Specifikimi i punëve	Cmimi per njesi	Shtesht
MIREMBA			
Pjeset rezerv (Ortopan)			
1	Senzori kryesor	50.00 €	50.00 €
2	Tubi ekspozues	30.00 €	30.00 €
QKMF			
1	Kalibrim I te gjitha parametrave	150.00 €	150.00 €
2	Aplikim I parametrave te ri	20.00 €	20.00 €
3	Instalim I softwerit	550.00 €	550.00 €
Totali:		8,000.00 €	7,280.00 €
			=720.00

Ju lutem, shikoni kalkulimin dhe korigjimet së bashku, ku vërehet dallimi. Gabimet aritmetike janë +/- 3.32%. (Shikoni parametër në OE të rekomanduar të korigjuar, ku shikohet qartë gabimi i cili është +/- 3.32%)

	Oferta OE	Korrigjimi	Dallimi	Dallimi %
MIREMBAJTJA E PAISJVE MJEKESORE - PAISJVE PER	5,200.00 €	4,732.00 €	468.00	5.00%
MIREMBAJTJA E PAISJVE MJEKESORE - PAISJVE PER	1,298.50 €	1,550.50 €	-252.00	-19.41%
Cmimi i Pergjithshem i peshuar (ofertat do te	6,498.50 €	6,282.50 €	216.00	3.32%

Ose

Për të llogaritur ndryshimin në përqindje nga V1 = 6498.5 në V2 = 6282.5, formula e përdorur.

- Llogaritja e ndryshimit:
 $V2 - V1 = 6282.5 - 6498.5 = -216$
- Llogarit përqindjen e ndryshimit:

Përgjigjja e AK ndaj Pretendimit Ankimor me Nr. 4

Ju sqarojmë se lidhur me pretendimin tuaj ankimor, për Operatorin Ekonomik të rekomanduar për kontratë është i pabazuar.

Sipas Dosjes së tenderit tek Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT), Kriteri i Dhënies është:

Kriteret e Dhënies	30.1	Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët me poentim ☒
--------------------	------	---

Ku poentimi është ndarë në dy (2) kategori: 65% dhe 35%

Rikapitullimi		Çmimi total i peshuar	Peshimi
MIREMBAJTJA E PAISJEVE MJEKESORE - PAISJEVE PER LABORATOR			65%
MIREMBAJTJA E PAISJEVE MJEKESORE - PAISJEVE PER QKMF			35%
Çmimi i Pergjithshem i peshuar (ofertat do te vleresohen ne baze te kesaj vlere). Kjo është vlera e cila do te duhet te shenohet ne Formularin e ofertes dhe do te lexohet gjate hapjes publike.		0.00 €	100%

Operatorin Ekonomik të rekomanduar, këtë pjesë e ka llogaritur tek 65% i poentimit, sipas Kriterit **Çmimin më të ulët me poentim**

1	Kalibrim I te gjitha parametrave	cope	1			
2	Aplikim I parametrave te ri	Cope	1			
3	Instalim I softwerit	Cope	1			

Ndërsa ju si Operator Ekonomik ankues nuk e keni llogaritur këtë pjesë tek kategoria e poentimit.

Pretendimi juaj në këtë pikë është i **pabazuara**

Nga konstatimet e lartcekur u vendos si në dispozitave të këtij Vendimi.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij **vendimi të AK-së ju munde të paraqitni** ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Vendimi Publikohet:

Në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

Astrit Mullabazi
Menaxher i Zyrës se Prokurimit
Komuna e Rahovecit